

## **Si të jesh i suksesshëm në punë.**

### **Cfarë të duhet të bësh dhe çfarë jo.**

Puna është bërë dhe do zërë akoma më shumë pjesë nga jeta jonë. Do thoni ju po në vëndet nordike po e shkurtojnë e më shumë orarat zyrtare të punës, por kjo sdo të thotë që njerëzit do dalin nga zyra dhe do rrinë këmbë mbi këmbë. Ka dhe punë sociale, dhe të rrish me familjen tënde, shoqërinë është punë. Kështu që në mënyre që të jemi sa më te suksesshëm në punën tonë do doja tju tregoja për disa gjëra që duhet të bëni dhe disa që sduhet të bëni.

Le të fillojmë me cfarë duhet të bëni!!

Ta dini se një fillim i mbarë i ditës së parë të punës mundëson shumë që të jeni të suksesshëm në punë. Duhet të jeni të punushuar dhe të fokusuar. Rrobat të jenë të pastra dhe rregullta. Vishni rroba me tone ngjyrash të njëjta. Por më e rëndësishmja është që të prezantoheni me të gjithë që nuk njiheni në zyrën tuaj, nëpër mbledhje dhe ti flisni, të jeni të qeshur me të gjithë. Kjo ju bën ju të hapur ndaj njohjeve të reja. Dhe nëse jeni të ndrojtur, si disa pre juve që njoh, vëtëm ti drejtosh dorën tjetrin tregon shumë për karakterin tënd. Ti do të jesh ti që nuk i druhesh sfidave profesionale, epo sfida e parë janë koleget. Po të duan dhe puna jote do jetë më e lehtë.

Dëgjo sa më shumë pasi ke shumë për të mësuar nga kolegët, puna e re, ambjenti. Si dhe bëj sa më shumë pyetje, dhe ta dish nuk ka pyetje të këqija ka përgjigjë të këqija. Ju duhet të jeni si një fëmi i sapo lindur që po eksploron botën për herë të parë. Mësoni të gjitha hilet. Si dhe një tip këtu mund tju ndihmojë të lidheni me një koleq të vjetër, të miqësoheni me të ai ose ajo do ju tregojë të gjitha hilet e sistemit.

Vendosni ose caktoni pritshmëritë që në fillim si me kolegët dhe me shefin tuja. Tregoni që ju jeni të gatshëm për çdo gjë, kërkoni një takim, tregoni kush jeni çfarë keni bërë, përgatituni nëse duhet dhe planifikoni një takim tjetër mbas një muaji dhe një tjetër mbas 2 muajsh. Nëse duhet dhe më shumë. Pranoni të ndihmoni çdo koleq, ose dhe ofroni ndihmën tuaj për të marrë përsipër diçka dhe mos të ket lidhje me punën tuaj, pasi kjo në fillim do duket shumë mirë, mbas disa muajsh ju dhe mund të refuzoni duke thënë që keni angazhime të tjera, por në hapat e para të krijimi të marrëdhënieve me punën ju duhet të merrni sa më shumë pëlqimin e njerëzve. Dhe kjo bëhet me çdo kusht.

Bëni kujdes nga stafi juaj ose kolegë të cilët mund të kenë dëshiruar vëndin tuaj përpara jush. Atëher, tregoni që ju jeni më të zotët, keni më shumë ekspserience, keni njohje dhe

që ju pranuat këtë pozicion për të futur një frymë të re ose për të ngritur diçka të re që është fusha juaj e ekspertizes. Gjithçka bëjeni me finesë dhe me qetësi.

Për të shkëlqyer kudo ju duhet të jeni të disiplinuar, të organizuar, të përpiktë në orare, dhe krijoni zakone të frutshme. Si dhe mos tju mungojë motivimi që të bëni gjërat e padëshiruara kur ju është thënë për ti bërë. Jini të rregullt në zyrë, jo rrëmujë, jo zhurmë, si dhe telefonata private ti bëni larg kolegëve. Emaile private asnjëherë në zyre, tek kompjuteri i punës të bëhet vetëm puna që ju është caktuar. Si dhe rrjete sociale është një tabu në zyrë. Më mirë merrni një telefon modern dhe aty mund të hulumtoni dhe të bëni çtë doni dhe kur të doni. Sdo ju shohë njëri që rrini kot në internet. Si dhe mos harroni qëndrimi në zyrë të jetë i saktë, nuk kemi dalë as për kafe as për xhiro.

Përsa i përket kafeve, drekave takime mas pune mësoni se ku pihen, hahen dhe bashkohen me kolegët aty do të mësoni shumë dhe do të njiheni më afër me njerëzit. Mos kini frikë të jini vetvetja dhe të flisni hapur, do bëni përnjëhere shoqëri. Por taktika më e mirë është të pyesni kolegët për çdo gjë të vogël. Si nga jeni? Ku jetoni? Beqar? Çfarë hobesh keni etj.

Një pikë tjetër shumë e rëndësishme është të shkoni nëpër sa më shumë takime, mbledhje, kafe, dreka, darka, evenimente, dmth duhet të tregoni që ju jeni prezent dhe ju keni dëshirë të merrni pjesë në këtë rreth të ri social që është puna juaj.

Jeta sociale digjitale ju duhet që të lidheni me njerëzit më shumë përtej punës përdoreni dhe hapni mundësisht të gjitha rretjet sociale që ju duken të frutshme për ju dhe mund ti përdorni. Aty mundohuni të tregoni më të mirën e vetes tuaj.

Së fundmi mos harroni koleget e vjetër. Takohuni dhe me ta ndonjëhere. Si dhe duke bërë këtë gjë ju hapni, krijoni mundësi të reja njohjesh, bashkëpunimi dhe dashurie për punën tuaj të re.

Dhe më kryesorja dilni gjithmonë 15-20 minuta më vonë nga orari zyrtar. Nuk them të rrini ulur por të punoni deri në atë orë. Jo të bëni shpikje të mëdha por mbase të planifikoni çdo bëni nesër.

Çfarë nuk duhet të bëni!!

Të flisni më shumë seç duhet. Të ngrini zërin. Të nisi një sherr në punë. Ktu do ndalem pak pasi është shumë delikate. Pasi e kam vënë re në zyrë me një koleg është shumë kollaj të nishësh një sherr një grindje dhe për një printim. Më mirë hapni rrugë, ose nëse ndodh diçka mundohuni ta anash kaloni dhe të nesërmen ta diskutoni me kolegun çfarë ndodhi. Keni për ta parë do bëheni më shokë se ai do e vlerësoj që nuk ja ndezët nervat por e latë të qetë. Në fund njerëz jemi smund të jemi me humor përditë.

Mos hani në zyrë, sidomosh ushqime me erë. Ose po hëngrët pyesni kolegët për leje. Ta dini sdo ju thotë njeri jo. Kurr! Zbatoni etikën e punës. Pyesni nëse ska si duhet veshur. Mos mungoni gjatë kohës së provës. Mos kërkoni leje. E di ne njerëz jemi kemi halle por 3 muaj ose 6 kalojnë shpejt dhe kur ju të merrni pikët maksimale tani e keni më kollaj së të ishtë ndryshe. Mos ngancmoni koleget, për ju meshkuj, ose ju femra mos u lidhni me kolegët e zyrës. Sepse, një zënkë dhe ju do keni shumë të vështirë të punoni me të. Mos rrini në tavolinën e punës duke parë telefonin, por bëni sikur punoni. Qëndrimi të jetë rrigoroz dhe jo diçka që ju bëni në shpi. Mos hidhni shumë parfum se më shumë do bezdisni kolegët sesa do i kënaqni. Mos i zvarrisni gjërat. Jepuni kohë projekteve, takimeve, emaileve, kërkesavë në punë. Mukajeti të le pa martuar por dhe pa punë. Mos u vononi në punë, hajdeni më mirë 5-10 minuta përpara dhe lexoni emailt ose ndonjë gazetë sesa me vonesë. Si dhe mos u vononi nëpër takime. Arrini të parët, merrni kartë vizitë me vehte. Jepjani tjetrin në dorë me të dyja duar dhe ashtu merrja kolegut. Respektoni pozicionin tuaj.

Ju a them gjitha këto pasi kjo puna jonë sa e vyer dhe e urryer duhet të bëhet me kujdes, me integritet dhe me dashurinë më të madhe. Po nuk e dashuroat punën, skeni për ta bërë kurrë siç duhet. Thjeshtë do harxhoheni se do e bëni me ego. Por dashurija më e fortë se egoja. Dhe mos mendoni se duke punuar fort, më fort për një gjë ju do arrini më shumë. Kurrën e kurrës! E keni parë gjë Hënën ta bëj me forcë rrotullimin rreth tokës? Jo, e bën me dashuri, është pjesë e saja. Në të njëjtën formë duhet ta bëni dhe ju punën tuaj. Të lozni më shumë se sa të punoni. Pasi puna ju han 8 ose më shumë orë të ditës dhe me të njëjtët njerëz. Kështu që investoni mirë kohën tuaj, në punën që doni dhe me njerëzit që doni.

EP